



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:003826

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05650095

KPPP.nr. 1261/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) Sh.A, me numër të regjistrimit të biznesit 71102130 dhe seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, nr. 5, Ndërtesa Elektrokosova, kati VII, kundër debitorit “Muqa Solar Company” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ExDC, llam. 8, lokal nr. 1, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu & Qerkini” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 657/21, të lejuar me datë 09.12.2021, nga Përmbaruesi Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Muqa Solar Company” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 657/21, të lejuar me datë 09.12.2021, nga Përmbaruesi Privat Eset Murati, ANULOHET.
- II. DETYROHET kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike që, në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit Muqa Solar Company” Sh.P.K., shumën e përgjithshme prej EUR 156.00 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike, mbi bazën e dokumentit të besueshëm; Ekstraktit nga librat

afarist nr. DPR – ..., ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 657/21, të datës 09.12.2021, me të cilin është urdhëruar debitori “Muqa Solar Company” Sh.P.K., që, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej EUR 4,347.70 për periudhën nga data 28.01.2019 deri me datë 11.11.2021, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetim se debitori përkundër borxheve paraprake, në momentin kur ka hyrë në shfrytëzim të banesës ka paguar me kohë të gjitha faturat, ndërsa në vitin 2019 ka arritur që matësin elektrik ta kthej në emër të vetin, duke mos pranuar asnjë obligim paraprak që ka pasur matësi, ashtu që ka nënshkruar Kontratën për furnizim me energji elektrike për konsumator jo shtëpiak. Më tej, ka theksuar se deri në mars të vitit 2019 faturat janë paguar nga personi fizik Xh.M., kurse nga kjo periudhë debitori ka përmbushur të gjitha obligimet e tij ndaj kreditorit, duke paguar të gjitha faturat mujore që kanë përkuar me shumën e faturës të secilit muaj. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimin në vlerë prej 156.00 EUR.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se propozimi për përmbarim është iniciuar në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit nga librat afarist, sipas nenit 29, par. 1.2 të LPP-së, duke precizuar kërkesën për periudhën kohore prej datës 28.01.2019 deri më datë 11.11.2021, në shumë prej EUR 4,347.70. Ka shtuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk janë të mbështetura në prova, siç përcaktohet me nenin 69, par. 4 të LPP-së. Tutje, ka bashkangjitur edhe faturat e energjisë elektrike në origjinal për periudhën kohore për të cilën kërkohet përmbushja e obligimit. Poashtu, sa i përket pretendimit për borxhe paraprake, sipas historikut të konsumatorit debitori nuk ka bërë ndonjë kërkesë për ndërrim të pronarit (shfrytëzuesit). Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.2 e të njëjtit nen përcakton ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave si dokumente të besueshme sipas së cilave mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se ekstrakti me shifër DPR ... mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të shërbyer si dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së, ngase në këtë dokument nuk është pasqyruar saktë detyrimi i debitorit dhe periudha kohore brenda të së cilës është akumuluar borxhi i kërkuar për përmbushje nga debitori.

Kjo për arsye se kreditori, me propozimin për përmbarim, ka kërkuar përmbushjen e borxhit për periudhën kohore prej datës 28.01.2019 deri më datë 11.11.2021, në shumë të përgjithshme prej EUR 4,347.70, mirëpo që kjo shumë, bazuar në ekstraktin e dorëzuar nga vet kreditori, nuk i përket periudhës kohore për të cilën kërkohet përmbushja, përkatësisht vlera prej EUR 4,347.70 rezulton të jetë borxh për periudha të mëhershme, ndërsa në ekstrakt fare nuk është pasqyruar periudha kohore në të cilën është krijuar kjo pjesë e detyrimit.

Për më tepër, nga shkresat e lëndës dhe provat e paraqitura nga ana e debitorit rezulton se i njëjti ka përmbushur të gjitha detyrimet për periudhën kohore për të cilën kërkohet përmbushja nga ana e kreditori dhe atë prej datës 28.01.2019 deri më 11.11.2021, pagesa këto të cilat madje janë pasqyruar edhe në ekstraktin mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim. Ndërsa, pjesa tjetër e detyrimit të kërkuar për përmbushje rezulton të jetë borxh i bartur nga periudha kohore të mëhershme për të cilën periudhë nuk është kërkuar përmbushje dhe nuk është pasqyruar fare në ekstraktin nga librat afariste të kreditorit, çka e bënë atë dokument jo të përshtatshëm për përmbarim.

Andaj, në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se si ka ardhur deri te borxhi kryesor i cili tani kërkohet nga kreditori për përmbushje dhe se për cilën periudhë kohore është akumuluar borxhi

i pretenduar nga ana e kreditorit, andaj si rezultat i kësaj, gjykata vlerëson se ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e debitorit në raport me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, mirëpo meqenëse të njëjtat pretendime janë të natyrës materiale, ndërsa në vlerësimin e gjykatës ekstrakti në rend të parë nuk i plotëson fare kushtet për të qenë dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së, nuk u lëshua në vlerësimin e tyre.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përbarimore, gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet debitorit në emër të prapësimit të ushtruar, në vlerë prej EUR 156.00, konform rregullores në fuqi për tarifatat e avokatëve.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1261/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.